# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-441861**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Policia turke ndalon dhjetëra persona gjatë bastisjeve kundër LGBTQ+ |
| ADRESA | `https://www.koha.net/bote/policia-turke-ndalon-dhjetera-persona-gjate-bastisjeve-kunder-lgbtq` |
| BURIMI | koha.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 00:56:53 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 15:12:39 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `fef82aef4fdfc9e8e5527e64e99afd04871db13edd40c3b7ee996fc89f3c6764` |
| TEKSTI | `3c244672028ff9ddfdf8a98a1424c4932232f65b66d819d50fefe36597066a1a` |
| PAMJA | `adbbea5e53e6f62d5b20be2233c1af2993ba7b5ab4c45902b55429299cf468fc` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1c35a4e78ec9ea2787121466165be2bed6b66e2afb5c7b6dff34bded674f80fe` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `dc70e080b3a4a4c4cbf64bcbb131092a1f212b073abe7679f17bd0bd0d647616` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1c35a4e78ec9ea2787121466165be2bed6b66e2afb5c7b6dff34bded674f80fe`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën** Kontribuo → **Letër lexuesit**

BOTË

# Policia turke ndalon dhjetëra persona gjatë bastisjeve kundër LGBTQ+




Foto: Associated Press

13 shtator 2026 17:12

Shpërndaje në:

Policia në Turqi ka arrestuar 47 persona gjatë një serie bastisjesh në bare homoseksualësh dhe në banesat e aktivistëve LGBTQ+, kanë njoftuar zyrtarët të dielën.

Bastisjet jan zhvilluar gjatë fundjavës në 12 provinca, si pjesë e një fushate të quajtur “Familja ime është e sigurt”, për të cilën qeveria turke thotë se synon mbrojtjen e vlerave familjare.

Një nga objektivat e operacionit ishte organizata LGBTQ+ Kaos GL.

Martesat mes personave të të njëjtës gjini nuk njihen në Turqi, ndërsa presioni ndaj çifteve homoseksuale është në rritje. Organizatat për të drejtat e njeriut në Turqi e kanë akuzuar qeverinë se po e përdor këtë fushatë për të goditur komunitetin LGBTQ+.

Sipas zyrës së prokurorit të Stambollit, gjatë bastisjeve janë arrestuar 26 persona dhe janë sekuestruar drogë, pajisje digjitale, alkool i kontrabanduar dhe një armë zjarri.

Edhe



Futboll • 17 kor 2026
Edhe 17 të arrestuar në Turqi për kurdisje dhe baste ilegale

Në një deklaratë të veçantë, zyra e prokurorit të Ankarasë ka thënë se 21 persona të tjerë ishin arrestuar në kuadër të një hetimi ndaj Kaos GL.

Organizata ka thënë se ishin arrestuar 50 aktivistë, më shumë se 10 prej tyre pas bastisjeve të policisë në banesat e tyre.

Ajo ka thënë gjithashtu se autoritetet kishin bllokuar disa faqe interneti dhe llogari në rrjetet sociale të lidhura me organizatat LGBTQ+.

Sipas organizatës, autoritetet e kanë akuzuar Kaos GL për

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

**Futboll.**
Çfarë thotë Edon Zhegrova?

**Shtojca për Kulturë.**
Mark Tirta – etnologu i terrenit, dijes dhe kujtesës shqiptare

**Futboll.**
Torresi në superformë i siguron PSG-së tjetër fitore

**Futboll.**
DAZN: Heroi i mbrëmjes ishte Arijanet Muriq

**Arbëri.**
14 shkolla në proces të mbylljes, shkaku i rënies së numrit të nxënësve

**Kronikë.**
Vëzhgimi me dronë, Policia në Gjakovë për 5 ditë pezulloi 152 patentë shoferë dhe shqiptoi 774 gjoba

publikimin e përmbajtjeve "të pahijshme" në internet, të cilat janë të qasshme edhe për fëmijët, dhe kanë kërkuar mbylljen e llogarisë së Kaos GL në X, si dhe të rreth 15 organizatave të tjera LGBTQ+.

Marrëdhëniet mes personave të të njëjtës gjini nuk përbëjnë vepër penale në Turqi, por homofobia është e përhapur. Presidenti Recep Tayyip Erdogan i ka përshkruar personat LGBTQ+ si "perversë" dhe i ka fajësuar për rënien e natalitetit.

Në kuadër të fushatës "Familja ime është e sigurt", ministri turk i Drejtësisë, Akin Gurlek, ka thënë se procedurat ligjore kanë nisur ndaj më shumë se 160 personave, si dhe ndaj një numri organizatash dhe kompanish në të gjithë vendin.


Edhe



Botë • 23 qer 2026

Turqia arreston mbi 200 të dyshuar për lidhje me grupe ekstremiste para samitit të NATO-s


Gurlek nuk ka thënë se sa persona ishin arrestuar, por ka deklaruar se bastisjet janë zhvilluar në kuadër të fushatës "Dekada e Familjes".

Megjithatë, Shoqata Turke për të Drejtat e Njeriut ka thënë se qeveria turke vitet e fundit e ka përdorur këtë fushatë për të goditur komunitetin LGBTQ+.

#TURQI #LGBTQ #ARRESTIME

#RECEP TAYYIP ERDOGAN #STAMBOLL #ANKARA


## Artikuj të ngjashëm



Botë • 30 dhj 2025

Turqia arreston edhe mbi 350 anëtarë të dyshuar të ISIS-it



Kronikë • 8 kor 2026

Aksioni për trafikim: 15 të arrestuar, mbyllen 10 qendra masazhi e nëntë lokale të muzikës live



Botë • 23 maj 2026

Policia turke arreston 13 opozitarë që zgjodhën udhëheqësin e rrëzuar



KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

+383 (0) 38 249 105 / [email protected]

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Download on the App Store

GET IT ON Google Play

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.